

VENDIM
Nr. 631, datë 10.10.2024

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 789, DATË 15.12.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET, MËNYRËN E
SHPËRBLIMIT DHE TRAJTIMIN E SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË
STATUSIN E NIVELIT TË LARTË, DHE TRAJNERËVE TË TYRE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 789, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, që ka arritur rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës nr. I, federata shqiptare sportive përkatëse, sportisti apo trajneri i tij aplikon në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”. Në aplikim përcaktohet rezultati përfundimtar në veprimtarinë ndërkombëtare, në të cilin sportisti ka marrë pjesë, shoqëruar me rezultatin përfundimtar të analizave *doping*, si dhe deklarimi i federatës që sportisti nuk ka rekorde pozitive të *doping*-ut të konfirmuar nga Organizata Kombëtare Antidoping. Ministria përgjegjëse për sportin verifikon përbushjen e kriterëve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për llogari të sportistit dhe të trajnerit të tij.”.

b) Pas pikës 17 shtohet pikat 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, zbatohet pasi ministria përgjegjëse për sportin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e procesit të implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet do të bëhen me kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për sportin.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për sportin, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku